

# AKT THEMELUES

SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "K U P A" SH.P.K.

Une **Qamil Kupa**, i biri i Rufatit, dtl.13.03.1948, banues ne Paskuqan, Tirane, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit" dhe te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" krijoj shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "K U P A" dhe me aktin themelues te saj si vijon:

## FORMIMI

### NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "K U P A" sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

## SELIA E SHOQERISE

### NENI 2

Selia e shoqerise tregtare private "K U P A" sh.p.k. do te jete ne Durres, Lagja Nr.14 Shkozet, Rruga Durres-Tirane.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

- Riveshje te gomave te perdorura per automjete
- Tregetimit me shumice e pakice dhe import eksport te:
  - Mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro - shtepiake, produkte bujqesore e blegtorale, fruta – perime, produkte te detit peshk etj. bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente, mishit e nenprodukteve te tij, qumeshtit e nenprodukteve te tij.
- Tregetim me pakice te karburanteve e vajrave lubrifikante.
- Hoteleri turizem, bar kafe – restorant.
- Transport mallrash brenda e jashte vendit.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape objekte e njesi sherbimi dhe do te bashkepunojte me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregtare private "K U P A" sh.p.k. do te jete 100.000 leke. dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut themelues. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mos demtojte interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, z. **Qamil Kupa**, i cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor i saj.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut themelues te shoqerise.

NENI 10

Ortaku themelues ka te drejte te emeruje edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktojte financier, likuidator per problemet e shoqerise, si edhe te pajtojne persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne gjykatën e shkalles se pare Durres.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakoneshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqerive tregëtare".

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

NENI 15

Akti i themelimit, u perpilua ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregëtare private "K U P A" sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

"K U P A" sh.p.k.

Qamil Kupa  
